



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M
Nr.1348, datë 26. 07. 2010

Për

“Percaktimin e sipërmarrjes së Albtelecom Sh.a., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 26.07. 2010, sipas procedurës së percaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, me objekt:

“Vlerësimin e pozitës në tregjet përkatëse të sipërmarrjes së Albtelecom Sh.a., mbi bazën e Dokumentit “Analizë e Tregut të Telefonisë Fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetë fikse: Dokumenti Përfundimtar”, si dhe vendosjen e masave rregulluese”.

mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Rregullimit Ekonomik, të përbërë nga:

- Relacioni shpjegues. (**Relacioni**);
- Dokumenti *“Analizë e Tregut të Telefonisë Fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetë fikse: Dokumenti Përfundimtar”*;
- Projekt-vendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485. (**Projektvendimi**).

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja ç) e neni 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Shkronja e) e pikes 1 dhe pika 17 e nenit 21 të “Rregullores se Brendeshme te AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te ERT-se, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe ne fuqi sipas pikës 3 te nenit 138 te ligjit nr. 9918;
4. “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, date 17.07.2009, te Keshillit Drejtues te AKEP (**Rregullorja**).
5. Vendimi i Keshillit Drejtues te AKEP, nr.1278, date 30.04.2010, Mbi ankimin administrativ te Albtelcom per tarifat e fazes IV nen-rregullim.

KESHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur, diskutimet ne mbledhje, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N :

1. Dokumenti *“Analize e Tregut te Telefonise Fikse: Tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumice te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit ne rrjete fikse: Dokumenti Perfundimtar”* reflekton punen e Drejtorise se Rregullimit Ekonomik si dhe komentet dhe verejtjet e bera gjate mbledhjes.
2. Dokumenti *“Analize e Tregut te Telefonise Fikse: Tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumice te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit ne rrjete fikse: Dokumenti Perfundimtar”*:
 - a. perben nje dokument te rendesishem rregullator ne baze se te cilit merren vendimet per FNT ne tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, te cilat jane shume te rendesishem per zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike ne Shqiperi;
 - b. eshte pergatitur pas kryerjes se keshillimit publik dhe permban komentet e paleve te interesuara dhe qendrimit e AKEP per komentet ne perputhje me nenin 35 te ligjit nr. 9918;
 - c. ka marre ne konsiderate rekomandimet e Autoritetit te Konkurrences te shprehura me Vendimin Nr.130, dt.23.11.2009, te derguar ne kuadrin e konsultimit publik te Analizes se tregut te telefonise fikse;
 - d. nga pikpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 9918 dhe Rregulloren per analizen e tregut;
 - e. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara per analizen e tregut ne nenin 31 e ne vijim te kreut VI te ligjit nr.9918, dhe Rregullores, perfshire perkufizimin e detajuar te tregjeve perkates dhe analizen e testit te tre kriterëve, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara per FNT;

- f. ka marre ne konsiderate rekomandimet dhe direktivat e Komisionit European dhe praktikat me te mira rregullatore ne vendet e Bashkimit European, parimet e ligjit te konkurrences dhe kushtet aktuale te tregut Shqiptar te telefonise fikse;
- g. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve per FNT eshte ne perputhje, me percaktimet e nenit 36 e ne vijim te kreut VI te ligjit nr.9918, me piken 5 te nenit 3 te Rregullores dhe me objektivat rregullatore te AKEP, te percaktuara ne nenin 7 te ligjit nr. 9918.

PER KETO ARSYE:

Duke marre ne konsiderate sa me siper, mbi bazen e vleresimit te pozites ne tregjet perkatese te sipermarresit Albtelecom Sh.a., sipas Dokumentit *“Analize e Tregut te Telefonise Fikse: Tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumice te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit ne rrjete fikse: Dokumenti Perfundimtar”*, ne mbeshtetje te pikes 1 te nenit 114, pikes 1 te nenit 115 te ligjit nr. 9918 dhe shkronjes e) te pikes 1 dhe pikes 17 te nenit 21 te Rregullores se Brendeshme, si dhe ne zbatim te kompetences ligjore te percaktuar ne shkronjen ç) te nenit 8 te ligjit nr. 9918,

V E N D O S :

1. Te percaktojë sipermarresin Albtelecom Sh.a., sipermarres me FNT ne tregjet perkatese te meposhtem:
 1. Tregu me pakice i aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse,per klientet familjare;
 2. Tregu me pakice i aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse,per klientet jo-familjare;
 3. Tregu me pakice per sherbimet lokale dhe/ose kombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse,per klientet familjare.
 4. Tregu me pakice per sherbimet telefonike nderkombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse,per klientet familjare.
 5. Tregu me pakice per sherbimet lokale dhe/ose kombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse,per klientet jo-familjare.
 6. Tregu me pakice per sherbimet nderkombetare te disponueshme per publikun te ofruara nga vendndodhje fikse,per klientet jo-familjare.
 7. Tregun e terminimit te thirrjeve drejt numrave gjeografike ne rrjetin fiks te Albtelecom;
 8. Tregun perkatese te origjinimit te thirrjeve nga vendndodhje fikse.
 9. Tregun perkatese te tranzitimit te thirrjeve kombetare ne rrjet fiks.
2. Zona gjeografike e tregjeve perkatese me FNT eshte kombetare apo territori i Republikës së Shqipërisë
3. Sipemarresi ALBTELECOM sh.a. i përcaktuar sipermarres me FNT, është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet përkatëse si më poshtë, por pa u kufizuar:
 - 3.1 *Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 te ligjit nr. 9918.*
 - 3.2 *Detyrimin e transparencies, sipas nenit 40 te ligjit nr. 9918.*
 - 3.3 *Detyrimi për ndarjen e llogarive, sipas nenit 41te ligjit nr. 9918.*

- 3.4 *Detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit, sipas nenit 42 të ligjit nr. 9918.*
- 3.5 *Detyrimi për zgjedhjen e bartesit dhe parazgjedhjen e bartesit (neni 43)*
- 3.6 *Detyrimin për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9918.*

4. Detyrimet e mesiperme në piken 3, përfshijne midis të tjerave:

4.1. ***Detyrimi i Mosdiskriminimit:***

Sipërmarresi Albtelecom Sh.a., të zbatojë kushte të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj sipërmarresve të tjere, që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t'u ofrojë sipërmarresve të tjere shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me çilesi të njëjta, sikunder ai i ofron për shërbimet e veta, për filialet ose partneret e tij

Sipërmarresi Albtelecom Sh.a., të perditesojë Oferten Reference të Interkoneksionit, të miratuar me vendimin nr.630, datë 10.02.2009 të Këshillit Drejtues, për ta pershtatur me përcaktimet e këtij vendimi dhe me ndryshimet dhe nevojat e tregut, brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

Sipërmarresi Albtelecom Sh.a., të publikojë marrëveshje të Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe Tregues Kryesore të Performancës (Key Performance Indicators -KPI) për interkoneksionin sipas përcaktimeve të Rregullores së Aksesit dhe Interkoneksionit.

4.2. ***Detyrimi i transparencës:***

4.2.1 Oferta Reference e Interkoneksionit e perditesuar nga Albtelecom duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm të nevojshme për interkoneksion me Albtelecom:

- a) Specifikimet teknike;
- b) Karakteristikat e rrjetit;
- c) Termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin;
- ç) Tarifat, përfshirë zbritjet e mundshme.

4.3. ***Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit:***

4.3.1 Sipërmarresi Albtelecom Sh.a., për terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve në rrjetin Albtelecom, duhet:

- a) t'u ofrojë palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij;
- b) të ofrojë terminim të thirrjeve hyrese derkombetare në nivel shumice, për t'u rishitur nga operatorët e autorizuar nga AKEP;
- c) të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;
- ç) të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- d) të ofrojë akses të hapur në nderfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rendesishme, të domosdoshme për nderveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual;
- dh) të ofrojë bashkevendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndertesat, tubacionet kabllorë ose shtyllat, kullat;
- e) të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar nderveprimin e shërbimeve pike fundore – pike fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent ;

- ë) *te ofroje akses ne sistemet mbeshtetese funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (software), te nevojshme, per te siguruar konkurrence te ndershme ne ofrimin e sherbimeve;*
- f) *te interkonektoje rrjetet ose facilitetet e rrjetit.*

Detyrimet e e mesiperme, i referohen vetem detyrimeve per mundesimin e terminimit, origjinimit dhe tranzitimit te thirrjeve ne rrjetin fiks Albtelecom, dhe jane te zbatueshme sipas mundesive/aftesive teknike dhe ekonomike te sipermarresit Albtelecom Sh.a, si edhe me tarifa te cilat mbajne parasysh investimet e kryera dhe nje norme te arsyeshme fitimi.

4.4. *Detyrimi per zgjedhjen e bartesit dhe parazgjedhjen e bartesit:*

Albtelecom ka detyrimin t'u ofroje pajtimtareve te rrjetit te tij, mundesine e zgjedhjes/parazgjedhjes se bartesit te thirrjeve dhe te beje perditesimin e ofertes reference te interkoneksionit sipas percaktimeve te vendimit te AKEP ne piken 4.5.3.

4.5. *Detyrimi per ndarjen e llogarive dhe detyrimi per kontroll te tarifave dhe sistemin e mbajtjes se llogarive:*

4.5.1 Tarifat e sherbimeve te telefonise fikse te ofruara nga Albtelecom jane:

- i) Objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP sipas pikave 4.5.2 dhe 4.5.3 per:
 - 1. sherbimet e ofruara pajtimtareve te Albtelecom me paketat "Familjare" dhe "Te Tjere"
 - 2. per sherbimet e terminimit, tranzitimit dhe origjinimit te thirrjeve dhe sherbimeve te interkoneksionit per thirrjet e origjinuara nga abonentet e rrjeteve publike telefonike ne RSH,;
 - 3. sherbimet e origjinimit, terminimit dhe tranzitimit te thirrjeve per bartesit e thirrjeve nepermjet zgjedhjes/parazgjedhjes se bartesit dhe per ofruesit e sherbimeve me karte te parapaguar;
- ii) Objekt i negociatave komerciale per sherbimet e terminimit ne rrjetin Albtelecom te thirrjeve hyrese nderkombetare;

4.5.2 Ne perputhje me nenin 57, pika 1 germa a):

- i) Tarifat maksimale te sherbimeve te telefonise fikse te ofruara pajtimtareve te Albtelecom me paketat "Familjare" dhe "Te Tjere", te aplikuar nga data 1.09.2010 te jene sipas vlerave te dhena ne tabelen e meposhteme:

Sherbimi	Njesia	Kategoria e Pajtimtarit/Paketa tarifore	
		Familjare	Te Tjere
Pajtimi Mujor	Lek/muaj	442	1500
Instalim Telefonik	Lek	4000	4000
Biseda Telefonike LOKALE brenda rrjetit Altelecom			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	3.00	3.90
Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	2..50	3.25
Biseda Telefonike KOMBETARE brenda rrjetit Altelecom			
Brenda Rajonit			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	3.00	3.90
Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	2.50	3.25
Midis Rajoneve			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	6.38	9.75
Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	5.13	8.22
Biseda Telefonike KOMBETARE drejt rrjeteve te tjere fiks			
Lokale			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	3.00	3.90
Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	2..50	2.60
Brenda Rajonit			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	4.48	6.50
Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	3.90	5.20
Midis Rajoneve			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	8.45	14.44
Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	6.74	10.40
Biseda Telefonike KOMBETARE drejt rrjeteve celulare			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	26.09	35.45

Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	20.00	26.00
Biseda Telefonike NDERKOMBETARE			

Brezi Orar i ZAKONSHEM 08.00-22.00				
ITALI	Fiks	Lek/min	15,38	19.99
	Celular	Lek/min	37,58	48.85
GREQI	Fiks	Lek/min	15,38	19.99
	Celular	Lek/min	37,58	48.85
MAQEDONI	Fiks	Lek/min	15,38	19.99
	Celular	Lek/min	37,58	48.85
KOSOVË	Fiks	Lek/min	15,38	19.99
	Celular	Lek/min	37,58	48.85
MALI I ZI	Fiks	Lek/min	15,38	19.99
	Celular	Lek/min	37,58	48.85
GJERMANI	Fiks	Lek/min	15,38	19.99
	Celular	Lek/min	37,58	48.85
FRANCË	Fiks	Lek/min	15,38	19.99
	Celular	Lek/min	37,58	48.85
ANGLI	Fiks	Lek/min	15,38	19.99
	Celular	Lek/min	37,58	48.85
SHBA	Fiks	Lek/min	15,38	19.99
	Celular	Lek/min		
KANADA	Fiks	Lek/min	15,38	19.99
	Celular	Lek/min		
Brezi Orar i REDUKTUAR 22:00 -8:00				
ITALI	Fiks	Lek/min	11,78	15.31
	Celular	Lek/min	28,57	37.14
GREQI	Fiks	Lek/min	11,78	15.31
	Celular	Lek/min	28,57	37.14
MAQEDONI	Fiks	Lek/min	11,78	15.31
	Celular	Lek/min	28,57	37.14
KOSOVË	Fiks	Lek/min	11,78	15.31
	Celular	Lek/min	28,57	37.14
MALI I ZI	Fiks	Lek/min	11,78	15.31
	Celular	Lek/min	28,57	37.14
GJERMANI	Fiks	Lek/min	11,78	15.31
	Celular	Lek/min	28,57	37.14
FRANCË	Fiks	Lek/min	11,78	15.31
	Celular	Lek/min	28,57	37.14
ANGLI	Fiks	Lek/min	11,78	15.31
	Celular	Lek/min	28,57	37.14

SHBA	Fiks	Lek/min	11,78	15.31
	Celular			
KANADA	Fiks	Lek/min	11,78	15.31
	Celular			

Shenime:

1. Tarifimi i thirrjeve behet ne baze te kohezgjatjes se thirrjes se suksesshme te matur ne sekonda (per second charging).
2. Per cdo thirrje me pagese aplikohet nje tarife fikse 0.83 lek per thirrje te suksesshme.
3. Per thirrjet drejt numrave pa pagese 0800 dhe sherbimeve me karte te parapaguar 0801, pajtimtari nuk paguan tarife per thirrje apo kohezgjatjen.
4. Per thirrjet jashte rrjetit Albtelecom, ne rast te rritjes se detyrimit te Albtelecom per palet e treta (perfshire tarifa me te larta te nje pale te trete nga operatoret aktuale, Albtelecom ka te drejte te aplikojte tarifa me te larta nga ato te tabelës se mesiperme, por jo me te larta se shuma e detyrimit per palet e treta dhe pjeses se mbajtur te Albtelecom (Pjesa e mbajtur e propozuar nga Albtelcom me shkresen Nr.Prot.709, date 08.02.2010, dhe miratuar nga AKEP me Vendimin Nr. 1182, date 10.03.2010). Per keto raste Albtelecom ka detyrimin e njoftimit te AKEP te pakten 15 dite kalendarike perpara aplikimit te tarifës se re dhe i shoqeruar me dokumentacionin perkates qe verteton rritjen e detyrimit te Albtelecom..
5. Tarifat deri me 31.08.2010 te jene te njejta me tarifat aktuale te Albtelcom, pervec rasteve kur aplikohet shenimi 4 me siper.
6. Tarifat jane pa TVSH

- ii) Tarifat maksimale te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit te thirrjeve ne rrjetin Albtelecom, te jene sipas vlerave ne tabelen e meposhteme:

	Aktuale-31.08.2010		1.09.2010-Sipas percaktimeve te Vendimit te AKEP ne piken 4.5.3.	
	Lek/minute	Lek/Thirrje	Lek/minute	Lek/Thirrje
Terminimi i thirrjeve me origjine kombetare ne Albtelecom:				
Segment Lokal	0.70	0,021	1,50	0,83
Segment njefish	1.06	0,032	2,50	0,83
Segment dyfish	1.54	0,046	3.50	0,83
Origjinimi ne Albtelecom:				
Segment dyfish	1.54	0,046	3.50	0,83

Tranzitimi ne Altelecom:				
Tranzit Njefish	0.36	0,011	1,5	0,83
Tranzit Dyfish	0.84	0,025	2.5	0,83

Shenim:

1. Per tarifat e origjinimit, terminimit dhe tranzitimit te thirrjeve per ofruesit e sherbimeve me karte te parapaguar, aplikohen vlerat sipas segmentit perkates dyfish ne rrjetin Altelecom.

2. Tarifat jane pa TVSH.

4.5.3 Zbatimi i detyrimit te ndarjes se llogarive dhe mbajtjes se llogarive (nenet 42 dhe 45) dhe zbatimi i detyrimit te orientimit ne kosto te tarifave te interkoneksionit dhe tarifave te pajtimtareve (neni 59) perfshire ribalancimin e plote te tarifave te Altelecom dhe detyrimet per zgjedhjen/parazgjedhjen e bartesit, do te kryhet ne baze te percaktimeve te ardhshme te AKEP, nepermjet nje vendimi qe do te merret brenda vitit 2010.

4.6. Pervec detyrimeve te citura me siper, Altelecom duhet te zbatoje dhe detyrimet e tjera te ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator per sherbimet e ofruara perdoruesve fundore dhe per akses dhe interkoneksionin, sipas rregullores aktuale dhe pas miratimit te AKEP sipas rregullores se Amenduar te Akses dhe Interkoneksionit.

5. Sipermarresi Altelecom ka detyrimin qe te zbatoje detyrime dhe specifikime te tjera te percaktuara nga AKEP, sipas nevojave te tregut, per statusin e FNT ne tregjet perkates te cituar ne kete vendim.

6. Afati i vlefshmerise se statusit me FNT ne tregjet perkates per sipermarresin Altelecom sh.a., eshte deri ne nxjerrjen e nje vendimi tjetër nga AKEP mbi bazen e analizës së tregut te kryer sipas nenit 34 te Ligjit 9918.

7. Vendimi VKD nr.410, date 13.11.2007, i Keshillit Drejtues te ERT, shfuqizohet.

8. Ne perputhje me piken 5 te nenit 3 te Rregullores per Analizen e Tregut, dhe nenin 34 te ligjit 9918:

8.1 Detyrimet e sipermarresit Altelecom sh.a. per tregun **Tranzitim të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin fiks, percaktuar ne VKD nr.410, date 13.11.2007, dhe VKM nr.854, date 18.06.2008, dhe detyrimet per tarifen e terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare, hiqen.**

8.2 **Heqja e detyrimeve per tranzitimin e thirrjeve nderkombetare behet efektive me 1.09.2010.**

8.3 **Heqja e detyrimeve per tarifen e terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare behet efektive me 1.11.2010.**

9. Dokumenti "Analize e Tregut te Telefonise Fikse: Tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumice te terminimit,

origjinimit dhe tranzitimit ne rrjete fikse: Dokumenti Perfundimtar” i bashkëngjitet këtij vendimi si Aneks nr.1 dhe eshte pjesë e tij.

10. Kundra ketij vendimi, mund te behet ankim ne Keshillin Drejtues te AKEP, brenda 30 (tridhjetë) diteve pas marrjes se njoftimit perkates.

Ky vendim hyn në fuqi ne daten e miratimit te tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANETARET E KESHILLIT DREJTUES:

- 1. Alketa Mukavelati**
- 2. Benon Paloka**
- 3. Ibsen Elezi**
- 4. Zamira Nurce**

ANEKS 1

“Analize e Tregut te Telefonise Fikse: Tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumice te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit ne rrjete fikse: Dokumenti Perfundimtar”